

Vendim nr. 205 datë 30.09.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Sonila Bejtja,	Anëtare
Genti Ibrahimimi,	Anëtar

në datën 30.09.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 6 (R) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: RIZAN ALIU

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 160, datë 31.10.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, nr. 2404, datë 19.12.2023 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, nr. 00-2024-556, datë 04.04.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 134, pika 2, si dhe 141, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Rizan Aliu në datën 18.06.2022 është arrestuar në flagrancë për veprën penale “Vrasja me dashje”, mbetur në tentativë, të parashikuar nga nenet 76 e 22 të Kodit Penal (KP). Në vijim, me kërkesë të organit të akuzës, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin nr. 12-2022-897(2692), datë 20.06.2022, ka caktuar ndaj kërkuesit masën e sigurimit personal “Arresti në burg”. Nga momenti i arrestimit në flagrancë, datë 18.06.2023, e në vijim kërkuesi ka qenë nën masën e sigurimit personal “Arresti në burg”.

2. Në datën 09.01.2023 prokuroria ka paraqitur në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës kërkesë për gjykimin e çështjes penale ndaj të pandehurit Rizan Aliu (kërkuesi). Ky i fundit, në datën 31.10.2023 ka paraqitur në gjykatën e shkallës së parë kërkesë për humbjen e fuqisë të paraburgimit dhe shuarjen e masës së sigurimit, duke pretenduar se dosja ka ardhur në gjykatë në datën 09.01.2023 dhe nga kjo datë deri në ditën e paraqitjes së kërkesës për shuarje të masës së sigurimit (datë 31.10.2023), ai ka vuajtur 14 muaj e 18 ditë, pra më shumë se 12 muaj, sipas parashikimeve të nenit 263, pika 2, shkronja “c”, të Kodit të Procedurës Penale (KPP). Kërkuesi e ka bazuar kërkesën e tij në përlllogaritjen e afateve të paraburgimit sipas nenit 57 të KP-së.

3. Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, me vendimin nr. 160, datë 31.10.2023, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së paraqitur nga kërkuesi për shkak të mosplotësimit të afatit të paraburgimit të parashikuar nga neni 263, pika 2, shkronja “c”, i KPP-së, me arsyetimin se afatet e paraburgimit për efekt të gjykimit llogariten si ditë kalendarike, ndërsa afatet e paraburgimit për efekt të dënimit llogariten me 1.5 ditë burgim. Kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë ka paraqitur ankim kërkuesi.

4. Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, me vendimin nr. 2404, datë 19.12.2023, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, me arsyetimin se në ankimin e paraqitur nga i pandehuri (kërkuesi) nuk ekziston asnjë shkak ligjor që të bëjë të cenueshëm vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Kundër vendimit të gjykatës së apelit ka ushtruar rekurs kërkuesi, duke ngritur pretendime për zbatim të gabuar të ligjit procedural, pasi llogaritja nga dy gjykatat e faktit, në lidhje me shuarjen e afateve të paraburgimit, është bërë në kundërshtim me nenin 263, pika 2, shkronja “c”, të KPP-së dhe nenin 57 të KP-së, pasi koha e paraburgimit duhej llogaritur një ditë paraburgim baras me një ditë e gjysmë burgim. Kërkuesi ka pretenduar, gjithashtu, njësim të praktikës gjyqësore.

5. Me vendimin nr. 00-2024-556, datë 04.04.2024, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, me arsyetimin se gjykata e apelit në vendimmarrjen

e saj ka sqaruar se mënyra e llogaritjes së parashikuar nga neni 57 i KP-së përbën një rregull për mënyrën e llogaritjes së burgimit në raport me masën e sigurimit të caktuar ndaj të pandehurit, ndërsa afatet kohore të përcaktuara në nenin 263 të KPP-së janë afate të zakonshme, të parashikuara në nenin 144 i KPP-së, pra afate kalendarike. Gjithashtu, ajo gjykatë e ka gjetur të pambështetur edhe pretendimin e kërkuarit për njësim të praktikës gjyqësore.

6. Në datën 23.05.2024 kërkuari i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 18.06.2024. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të ligjit nr.8577/2000, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore të anëtarëve të Gjykatës, sipas nenit 18, pika 1, shkronja “b”, të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuarit

7. **Kërkuari**, në mënyrë të përmblodhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, pasi vendimet e gjykatave janë marrë në shkelje të neneve 263, pika 2, shkronja “c” dhe 144, pika 1, të KPP-së, në interpretim dhe zbatim të gabuar të nenit 57 të KP-së, si dhe në shmangie të praktikës së Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (vendimi unifikues nr. 6, datë 11.11.2003). Sipas tij, gjykatat duhet t'i llogarisnin afatet e përcaktuara në nenin 263 të KPP-së të lidhura me nenin 57 të KP-së, pra një ditë paraburgim baras me një ditë e gjysmë burgim.

III

Vlerësimi i Kolegjit

8. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast,

duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyqimit kushtetues.

9. Kolegji vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja ”i” dhe 2, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor në të cilin janë dhënë vendimet gjyqësore të kundërshtuara prej tij, ndaj ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

10. Kërkuesi plotëson edhe kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, pasi rezulton se u është drejtuar të gjitha shkallëve të gjyqimit, duke paraqitur kundërshtimet e tij në lidhje vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, për rrjedhojë nuk ka mjet tjetër ligjor për të shteruar për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar përveç kërkesës në këtë Gjykatë, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 2, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000.

11. Kolegji vlerëson se kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, mban datën 04.04.2024, ndërkohë që ankimi kushtetues është paraqitur në datën 23.05.2024, pra brenda afatit 4-mujor.

12. Për sa i përket legjitimitetit *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar se vendimet e kundërshtuara i kanë cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor, pasi janë marrë në shkelje të neneve 263, pika 2, shkronja “c” dhe 144, pika 1, të KPP-së, në interpretim dhe zbatim të gabuar të nenit 57 të KP-së, si dhe në shmangie të praktikës së Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke iu referuar vendimit unifikues të asaj gjykate nr. 6, datë 11.11.2003. Sipas kërkuesit, ndryshe nga sa kanë vendosur gjykatat, ato duhet të i llogarisnin afatet e përcaktuara në nenin 263 të KPP-së të lidhura me nenin 57 të KP-së, duke llogaritur një ditë paraburgim të barabartë me një ditë e gjysmë burgim.

13. Gjykata në mënyrë konstante në jurisprudencën e saj ka pohuar se interpretimi i ligjit dhe zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Mënyra se si gjykatat

e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim para tyre nuk përbën lëndë kushtetuese, me përjashtim të rastit kur kjo mënyrë veprimi e gjykatës së zakonshme provohet se ka cenuar të drejta kushtetuese të individit, në kuptimin që procesi në tërësinë e tij rezulton haptazi i paarsyeshëm ose arbitrar. Nga ana tjetër, Gjykata ka pohuar se detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 32, datë 03.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Kolegji, bazuar në natyrën dhe përmbajtjen e pretendimeve të parashtruara nga kërkuesi, vëren se ato kanë të bëjnë me mënyrën se si gjykatat e zakonshme kanë zbatuar dhe interpretuar dispozitat procedurale të zbatueshme që kanë të bëjnë me llogaritjen e afateve të paraburgimit për efekt të kërkesës për shuarjen e masës së sigurimit të kërkuesit, pra, në thelb, me standardin e arsytimit të atyre vendimeve, i cili, duke qenë me natyrë kushtetuese, do të vlerësohet në vijim në lidhje me bazueshmërinë e tij.

15. Në lidhje me këtë standard kushtetues, Gjykata ka vlerësuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 3, datë 20.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje dhe në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre (*shih vendimet nr. 79, datë 14.12.2017; nr. 63, datë 23.09.2015; nr. 3, datë 26.01.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në përputhje me standardet e mësipërme, Kolegji vëren se gjykatat e zakonshme, në përputhje me kompetencat e tyre, pasi kanë marrë në shqyrtim kërkimet dhe pretendimet e kërkuesit të parashtruara në kërkesë dhe ankimet përpara atyre gjykatave, i kanë kthyer atij përgjigje të arsyetuar se mënyra e llogaritjes së afateve të paraburgimit, e parashikuar nga neni 57 i KP-së, përbën një rregull për mënyrën e llogaritjes së burgimit në raport me masën e sigurimit të caktuar ndaj të pandehurit, ndërsa afatet kohore të përcaktuara në nenin 263 të KPP-së janë afate të zakonshme, të parashikuara në nenin 144 i KPP-së, pra afate kalendarike. Kolegji vlerëson se

kjo mënyrë e zbatimit dhe interpretimit të ligjit nga gjykatat e zakonshme nuk rezulton të ketë qenë arbitrare apo të mos respektojë standardet e mësipërme të arsyetimit të vendimit gjyqësor, pra që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë sipas nenit 42 të Kushtetutës. Për sa kohë që nuk rezulton që gjykatat e zakonshme të kenë interpretuar në mënyrë arbitrare dispozitat ligjore të zbatueshme në rastin e kërkuarit, pretendimi i tij për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor është haptazi i pabazuar.

17. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.